

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PKL.-KZZ. Nr. 76/2012  
Prishtinë  
17 tetor 2012

## NË EMËR TË POPULIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej  
Gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen si kryetar i kolegjit,  
Gjyqtarit të EULEX-it EULEX Gerrit-Marc Sprenger,  
Gjyqtares së Gjykatës Supreme Emine Mustafa,  
Gjyqtares së Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe  
Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Në çështjen penale kundër të pandehurit:

L.B

[REDACTED] në paraburgim që nga  
data 7 prill 2010,

I shpallur fajtor në shkallë të parë me aktgjykimin P. Nr. 164/2010 të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, të datës 8 shkurt 2011, për kryerje të këtyre veprave penale:

Vrasje e rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 7 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje KPK) dhe

Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

Dhe i dënuar me dënim unik me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim;

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AP.-KZ. 173/2011, të datës 14 dhjetor 2011, ka konfirmuar dënimin dhe sanksionin penal duke e ndryshuar dispozitivin;

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur më 11 prill 2012 nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të të pandehurit kundër aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KZ. 173/2011, të datës 14 dhjetor 2011, dhe pas shqyrtimit të përgjigjes së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK) të paraqitur më 25 maj 2012, pas këshillimit të mbajtur më 17 tetor 2012,

Lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 11 prill 2012 kundër të pandehurit REFUZOHET SI E PABAZUAR.



## ARSYETIMI

### I. Historia e procedurës

Më 6 shtator 2010 Prokurori Publik i Qarkut të Prizrenit paraqiti Aktakuzën PP. Nr. 92/2010 kundër të pandehurit [REDACTED] (L.B)

Më 6 tetor 2010 Gjykata e Qarkut e Prizrenit konfirmoi aktakuzën kundër [REDACTED] (L.B) me aktvendimin KA. Nr. 140/2010.

Më 15 tetor 2010 pala e dëmtuar paraqitën një kërkesë në Asamblenë se Gjyqtarëve të EULEX-it për marrjen e kësaj çështje penale.

Më 4 nëntor 2010, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, në bazë të nenit 3.3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve të dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tash e tutje LmK), vendosi ta marrë këtë lëndë dhe këtë lëndë t'ua caktojë Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

Shqyrtimi gjyqësor kundër të pandehurit dhe të miturit E.B. u mbajt gjatë muajve janar dhe shkurt 2011.

Prokurori i Qarkut e ndryshoi aktakuzën në fjalën e tij përmbyllëse.

Më 8 shkurt 2011 u shpall aktgjykimi P. Nr. 164/2010 me të cilin i pandehuri shpallet fajtor dhe dënohet siç përmendet më lart.

Prokuroria, i pandehuri si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar paraqitën ankesë kundër këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AP.-KŽ. 173/2011, të datës 14 dhjetor 2011, ka ndryshuar dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë duke e konfirmuar fajësinë dhe dënimin kundër të pandehurit [REDACTED] (L.B) (E.R)

Më 11 prill 2012 avokati mbrojtës [REDACTED] paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Më 25 maj 2012 ZPShK-ja paraqiti përgjigj ndaj kërkesës së të pandehurit.

### II. Parashtresat e palëve

#### a) Kërkesa në emër të të pandehurit

Mbrojtja propozon të ndryshohet aktgjykimi P. Nr. 164/2010 i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, i datës 8 shkurt, dhe aktgjykimi AP.-KŽ. Nr. 173/2011 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 14 dhjetor 2011, dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Avokati mbrojtës kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë e bazon në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 paragrafi 1 pikat 10) dhe 12) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje: KPPK) dhe në shkelje të ligjit penal nga neni 404 pika 1 e KPPK-së.

Në veçanti, kërkesa pohon se aktgjykimi e tejkalon aktakuzën, se dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin dhe se arsyetimi nuk përmban fakte vendimtare.

Avokati mbrojtës parashtron se gjersa aktakuza e përcakton të miturin E. B. si personin i cili e ka qëlluar viktimën nga afërsia me pistoletën “Zastava”, me kalibër 6.35 mm me numër serik ET-8111258 dhe që me një plumb e ka qëlluar në pjesën e pasme të kokës, Gjykata e Qarkut në aktgjykimin e saj i akuzon të dy të bashkëpandehurit për përdorim të pistoletës. Kështu Gjykata e Qarkut e ndryshoi identitetin objektiv të aktakuzës dhe prandaj edhe e ka tejkalar atë. Gjykata e ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] për përdorim të pistoletës kurse me aktakuzë nuk është akuzuar, dhe me këtë e ka tejkalar aktakuzën. Duhet të ekzistojë një identitet në mes aktakuzës dhe aktgjykimit sa i përket fakteve esenciale, lidhur me identitetin objektiv (ngjarjen) dhe identitetin subjektiv (personin). Vetëm prokuroria mund ta ndryshojë përshkrimin e këtyre fakteve esenciale.

L.B

Gjykata Supreme e ka përsëritur këtë shkelje të gjykatës së shkallës së parë. Në vend se ta pranojë ankesën, ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lëshojë një aktgjykim të ri, Gjykata Supreme prapë ka lëshuar aktgjykim të njëjtë.

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk arrin të sqarojë natyrën dhe thelbin e “marrëveshjes paraprake” të pretenduar, mbi bazën e së cilës dy të pandehurit bashkëvepruan. Nuk përshkruan si është bërë plani, për çfarë ishte diskutuar, ku janë takuar bashkëkryerësit dhe cili ishte qëllimi i vrasjes. Shpjegimi i ofruar – se marrëveshja për kryerjen e vrasjes ishte bërë me një thirrje telefonike – nuk është logjik e as i besueshëm.


Aktgjykimi nuk arrin as të sqarojë kontributin e saktë të të pandehurit kinse sipas planit të përbashkët, çfarë veprime saktë kishte ndërmarrë për ekzekutimin e atij plani të përbashkët dhe se rezultati ishte si pasojë e bashkëpunimit të bashkëkryerësve.

Gjithashtu mungon sqarimi i elementit subjektiv të veprës penale. Aktgjykimi nuk sqaron se i pandehuri kishte për qëllim ta kryejë veprën penale dhe se ishte i vetëdijshëm për pasojat.

#### b) Përgjigja e ZPShK-së

ZPShK-ja konsideron se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtja është e pabazuar dhe propozon të refuzohet. Nuk ekziston asnjë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale as shkelje të ligjit penal.

Përshkrimet faktike në dispozitivët e aktgjykimeve janë të qarta, pa kundërtënie, të kuptueshme dhe përmbajnë të gjitha elementet esenciale të veprës penale të ndryshimi të bërë me anë të aktgjykimit të shkallës së dytë vetëm qartëson faktet tanimë të njohura të aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk e ndryshon gjendjen faktike të



Faktet në dispozitivët e aktgjyqimeve të kundërshtuara janë përfundimtare dhe, në përputhje me nenin 451 paragrafin 2 të KPPK-së, nuk mund të kundërshtohen me anë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimi se aktgjykimi e tejkalon aktakuzën është pa meritë. Aktgjykimi nuk ka ndryshuar as identitetin objektiv e as subjektiv të aktakuzës. Dënimi është bazuar përbrenda kornizës së përcaktuar me aktakuzë sa i përket ngjarjes kritike dhe personave të akuzuar.

### III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Kolegji gjen se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme por e pabazuar.

Në përputhje me nenin 455 paragrafin 1 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës e ka kufizuar veten në ekzaminimin e këtyre shkeljeve të ligjit në të cilat pretendon pala në kërkesë.

Gjykata gjen se pretendimi se aktgjykimi i formës së prerë i kundërshtuar e tejkalon aktakuzën është pa meritë. Aktgjykimi i shkallës së dytë qëndron brenda kornizës faktike objektive dhe subjektive të përcaktuar në aktakuzë. Nuk ndryshon përshkrimin e asnjërit fakt esencial lidhur me të pandehurin [redacted]. Gjersa aktakuza e cakton të miturin E. B. si qitës, aktgjykimi këtë çështje e lë të hapur, i cili dyshim shkon në favor të dy të bashkëpandehurve, prandaj asnjërin nuk e përcakton shprehimisht si qitës. Në formën përfundimtare të aktgjykimit thuhet:

*“Njëri nga të pandehurit, por me marrëveshje paraprake të të dyve, qëllimisht ka përdorë pistoletën ‘Zastava’ ... dhe ka qëlluar viktimën [redacted] nga afërsia në pjesën e pasme të kokës, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse.”*

Avokati mbrojtës gabon kur pretendon se aktgjykimi i formës së prerë shpall klientin e tij fajtor për përdorimin e pistoletës. Formulimi, siç është ndryshuar në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme është mjaft i qartë dhe se nuk i jep përgjegjësi individuale asnjërit të bashkëpandehur për përdorimin e pistoletës. Aty vetëm thuhet se rezultatit ka ndodhur si pasojë e veprimit të tyre të përbashkët.

Nëse në të vërtetë aktgjykimi do të kishte ndryshuar faktet e përshkruara në aktakuzë vetëm në lidhje me të miturin E. B., kjo nuk do të mund të përbente shqetësim apo ndonjë shkelje për të pandehurin [redacted]. Faktet e përshkruara në aktakuzë janë të detyrueshme vetëm në lidhje me të pandehurin e rritur. Korniza e akuzave të caktuara në aktakuzë është caktuar vetëm në lidhje me atë, kurse faktet në lidhje me akuzat kundër të miturit janë përcaktuar me propozimin për shqiptimin e dënimit kundër të miturit<sup>1</sup> - një dokument tjetër dhe i veçantë.

Në këtë rast, i pandehuri nuk është akuzuar në aktakuzë për përdorimin e pistoletës personalisht (por i mituri E.B. është përmendur) dhe ai nuk është shpallur fajtor në aktgjykimin e formës së prerë për këtë akt të veçantë. As aktakuza e as aktgjykimi i formës

<sup>1</sup> Shih propozimin PPM. Nr. 09/2010, të paraqitur më 6 shtator 2010 nga Zyra e Prokurorit të Qarkut në Prizren

së prerë nuk ia cakton të pandehurit [REDACTED] personalisht përgjegjësinë penale për të shtënat vdekjeprurëse. Kolegji i referohet paragrafit 44 të aktgjykimit të Gjykatës Supreme ku gjykata shtjellon:

*“Në asnjë moment në arsyetim të aktgjykimit nuk theksohet se [REDACTED] ka përdorë pistoletën. ...nuk ka nevojë të vërtetohet nëse ka qenë [REDACTED] apo (i mituri) E.B. ai që ka shtënë, përderisa vrasja e [REDACTED] ka qenë qëllim i përbashkët dhe që të dytë kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e veprës penale ...”*

Aktgjykimi i formës së prerë në mënyrë të qartë korrespondon me aktakuzën se ai qëllimisht ka kontribuar me veprimet e tij në bashkëpunim me të miturin B. D. në vdekjen e viktimës dhe për këtë arsye është fajtor për kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje në shkelje të nenit 147 paragrafit 7 në lidhje me nenin 23 të KPK-së.


Aktgjykimi mbetet pranë përshkrimin faktik të ngjarjes – privimit të viktimës nga jeta nga ana e dy të pandehurve duke vepruar në bashkëpunim dhe në bazë të marrëveshjes paraprake. Rezultati aktual – vdekja e viktimës –ka ndodhë si pasojë shkakore e kontributeve të tyre individuale. Aktgjykimi nuk bën asnjë përcaktim, se cili nga dy të pandehurit ka qëlluar me të shtënë vdekjeprurëse, por vetëm se ka qenë cilido prej tyre. Viktima është privuar nga jeta si rezultat i qëllimshëm i bashkëpunimit të të dy të pandehurve në bazë të një plani të përbashkët.

Kolegji refuzon pretendimet e të pandehurit si të pabazuara se aktgjykimi dështon që të sqaroj natyrën dhe esencën e “marrëveshjes paraprake” të pretenduar, në bazë të cilës dy të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje. Të dy aktgjykimet vazhdimisht kanë arsyetuar dhe përshkruar në thellësi dhe në detaje marrëveshjen e përbashkët paraprake. Referencë i bëhet paragrafit 50 të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ku gjykata përshkruan shkëmbimin e tekst mesazheve një ditë para vrasjes në mes [REDACTED] dhe dëshmitarit [REDACTED] në lidhje me planin e të pandehurit që të takohet me bashkëkryerësin e tij në ditën e ardhshme.

Më tutje, dëshmia e dëshmitarit [REDACTED], sipas të cilit [REDACTED] i kishte thënë atij se më 16 maj 2009 pak kohë pas të shtënave se “Ne kemi kryer një vrasje.” Është e besueshme dhe tregon planifikimin dhe përgjegjësinë e përbashkët për aktin kriminal. Dëshmitari, gjithashtu ka theksuar se në atë kohë ata nuk e akuzonin njëri tjetrin.

Indikatorë plotësues me peshë për një marrëveshje dhe kryerje të përbashkët të veprës penale janë dorëzimi i pistoletës nga i mituri E.B. te i pandehuri, siç është dëshmuar nga dëshmitari [REDACTED], paralajmërimi i dëshmitarit nga të dytë - i pandehuri dhe i mituri (paragrafi 52 i aktgjykimit të Gjykatës Supreme), si dhe takimi i serishëm i të pandehurit me të miturin E.B. vetëm pak kohë pasi që ishin kthyer në shtëpi pas vrasjes (paragrafi 53 i aktgjykimit të Gjykatës Supreme).

Gjykata Supreme nuk pajtohet me kundërshtimin e të pandehurit se marrëveshja kryer vrasjen nuk ka mundur të bëhet përmes thirrjes telefonike. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk pohon se marrëveshja paraprake është bërë vetëm përmes një thirrje telefonike. Të gjitha rrethanat faktike të përmendura më parë vërtetojnë se ka ekzistuar një marrëveshje paraprake që vrasja të kryhet së bashku. Nuk kërkohet që të vërtetohet saktësisht kur është bërë marrëveshja, nëse aktgjykimi mund të vërtetojë se një marrëveshje ka ekzistuar dhe që ajo ka qenë baza për kryerjen e përbashkët të veprës penale.



Mbrojtja nuk ka mbështetur pa-kuptueshmëritë, kundërthëniet e tjera të pretenduara të dispozitivit apo kundërthëniet me arsyetimin.

Kolegji është i mendimit se aktgjykimi i kundërshtuar në formën e tij të prerë nuk përmban shkelje të ligjit penal.

Mbrojtja pohon se aktgjykimet e kundërshtuara nuk shtjellojnë kontributin e konsiderueshëm individual për veprën penale nga i pandehuri [REDACTED] siç kërkohet me nenin 23 të KPK-së. Kolegji refuzon këtë pretendim si të pabazuar. Në dispozitivin e aktgjyimit të kundërshtuar si dhe në arsyetim është sqaruar në mënyrë mjaftueshme se i pandehuri me praninë e tij gjatë kryerjes së vrasjes, gjatë të shtënave mbi viktimën dhe më pastaj largimin e kuletës ka dhënë mbështetje dhe në këtë mënyrë ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e veprës penale, në kuptim të nenit 23 të KPK-së. L.B

Lidhur me mungesën e arsyetimit mbi elementin subjektiv të dashjes në aktgjykimin e kundërshtuar – siç pretendohet në kërkesën e të pandehurit – kolegji është i mendimit se *mens rea* e të pandehurit është arsyetuar mjaftueshëm. Gjykata i referohet paragrafëve 41 deri 43 dhe paragrafit 45 të aktgjyimit të shkallës së dytë, ku të gjitha elementet subjektive të kërkuara me ligj, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se ekzistojnë. Gjykata e shkallës së dytë, kryesisht gjatë referimit në arsyetimin e aktgjyimit të shkallës së parë ka elaboruar mënyrën e vlerësimit të dashjes së të pandehurit nga Gjykata e Qarkut, formën e dashjes, dashjen që përfshinë kontributin e tij individual në veprën penale dhe paramendimin në lidhje me rezultatin aktual të vrasjes së viktimës [REDACTED] B.V

Në bazë të arsyeve të përmendura dhe sipas nenit 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës

Tore Thomassen  
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor i EULEX-it



Republika e Kosovës  
Gjykata Supreme e Kosovës  
PKL.-KZZ. Nr. 76/2012  
Prishtinë  
17 tetor 2012

Punëtori i autorizuar  
Ovlašteni radnik